L I G J
Nr.8759, datë 26.3.2001

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË "KONVENTËN NDËRKOMBËTARE PËR ASISTENCË TË NDËRSJELLË ADMINISTRATIVE PËR PARANDALIMIN, HETIMIN DHE GODITJEN E SHKELJEVE DOGANORE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në "Konventën ndërkombëtare për asistencë të ndërsjellë administrative për parandalimin, hetimin dhe goditjen e shkeljeve doganore".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2960, datë 6.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

KONVENTA
NDËRKOMBËTARE MBI ASISTENCËN RECIPROKE ADMINISTRATIVE PËR PARANDALIMIN, HETIMIN DHE GODITJEN E SHKELJEVE DOGANORE

(NAIROBI, 9 QERSHOR 1977)

HYRJE

PALËT KONTRAKTUESE në Konventën në fjalë, themeluar nën mbikëqyrjen e Këshillit të Kooperimit Doganor,

Duke marrë parasysh që shkeljet ndaj Ligjit Doganor janë të dëmshme për interesat ekonomike, sociale dhe fiskale të Shteteve dhe interesave legjitime të tregtisë,

Duke marrë parasysh se aksionet ndaj shkeljeve doganore mund të kryhen më efektivisht nëpërmjet kooperimit ndërmjet Administratave Doganore, dhe se ky kooperim është një nga qëllimet e Konventës duke themeluar një Këshill Kooperimi Doganor,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

KREU I
PËRKUFIZIME

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Konvente:

(a) termi "Ligj Doganor" do të thotë gjithë dispozitat statuore ose rregullatore që janë në fuqi ose administrohen nga Administrata Doganore lidhur me importimin, eksportimin ose tranzitin e mallrave;

(b) termi “Shkelje Doganore” do të thotë çdo thyerje ose përpjekje për thyerje të ligjeve doganore;

(c) termi “Mashtrim Doganor” do të thotë një shkelje doganore nga e cila një person mashtron doganat dhe në këtë mënyrë i shmanget pjesërisht ose tërësisht pagesave të detyrimeve dhe taksave të importit ose eksportit ose zbatimit të kufizimeve dhe ndalimeve të parashtruara në Kodin Doganor ose përfiton ndonjë avantazh në kundërshtim me ligjin Doganor;

(d) termi “kontrabandë“ do të thotë mashtrimi doganor që konsiston në lëvizjen e mallrave përmes një kufiri Doganor në një mënyrë klandestine;

(e) termi “detyrime dhe taksa doganore” do të thotë detyrime Doganore dhe detyrime të tjera, taksa, kuota ose pagesa të tjera të cilat mblidhen gjatë ose në lidhje me importin ose eksportin e mallrave, por pa përfshirë kuotat ose pagesat e tjera të cilat janë të kufizuara më shumë, afërsisht me koston e shërbimeve të tjera;

(f) termi “person” do të thotë si personat fizikë ashtu dhe ata juridikë, në rastet kur konteksti nuk kërkon diçka tjetër;

(g) termi “Këshill” do të thotë organizata e ngritur nga konventa e cila themelon një “Këshill të Kooperimit Doganor”, kryer në Bruksel më 15 dhjetor 1950;

(h) termi “Komiteti Teknik Permanent” do të thotë Komiteti Teknik Permanent i Këshillit;

(i) termi “ratifikim” do të thotë ratifikim, pranim ose aprovim.

KREU II

Neni 2
Fusha e veprimit të Konventës

1. Palët Kontraktuese të lidhura nga një ose më tepër Anekse të kësaj Konvente bien dakord se Administratat e tyre Doganore do të përballojnë asistencë reciproke ndaj njëra-tjetrës me synim parandalimin, hetimin dhe goditjen e shkeljeve doganore, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

2. Administrata Doganore e një Pale Kontraktuese mund të kërkojë asistencë të ndërsjellë siç parashikohet në paragrafin 1 të këtij Neni gjatë çdo lloj investigimi ose në lidhje me ndjekjet penale ose administrative që ndërmerren nga një Palë Kontraktuese. Nëse Administrata Doganore nuk e kryen vetë këtë ndjekje, ajo mund të kërkojë asistencë të ndërsjellë vetëm brenda limiteve të kompetencës së vet në këtë proces. Në mënyrë të ngjashme, nëse ndjekja kryhet në vendin e administratës që i kërkohet asistencë, kjo e fundit jep asistencën e kërkuar brenda limiteve të kompetencave të veta në këtë proces.

3. Asistenca e ndërsjellë siç përshkruhet në paragrafin 1 të këtij Neni nuk do të zgjerohet në kërkesa për arrestimin e personit ose grumbullimin e detyrimeve, taksave, pagesave, gjobave ose parave të tjera në interes të Palës Kontraktuese.

Neni 3

Nëse njëra Palë Kontraktuese konsideron se asistenca e kërkuar bie në kundërshtim me sovranitetin, sigurinë ose interesa të tjera themelore kombëtare ose dëmton interesat legjitime komerciale të ndonjë kompanie, publike ose private, ajo mund të mohojë dhënien e kësaj asistence ose ta japë sipas disa kushteve ose kërkesave të përcaktuara.

Neni 4

Nëse Administrata Doganore e një Pale Kontraktuese kërkon asistencë e cila në vetvete nuk do të ishte në gjendje ta jepte këtë asistence nëse do t’i kërkohej nga një Palë Kontraktuese, duhet ta theksojë këtë në kërkesën e vet. Përgjigjja për këtë kërkesë do të varet nga konsiderata e Palës së Kërkuar Kontraktuese.

KREU III

Neni 5
Procedura e asistencës së përgjithshme

1. Çdo inteligjencë, dokument ose informacione të tjera të komunikuara ose të përfituara në këtë Konventë:

(a) do të përdoret vetëm për qëllimet e specifikuara në këtë Konventë, duke përfshirë përdorimin në procedimet penale ose administrative, dhe varur nga kushtet e vëna nga Administrata Doganore e cila i ka dërguar; dhe

(b) do të ketë në vendin marrës të njëjtën mbrojtje lidhur me konfidencialitetin dhe sekretin zyrtar; siç aplikohet në atë vend për të njëjtat lloje dokumentesh, inteligjence dhe informacione të tjera të përfituara në territorin e vet.

2. Kjo lloj inteligjence, dokumenti ose informacioni mund të përdoret për qëllime të tjera vetëm me aprovimin e shkruar të Administratës Doganore që i ka dhënë dhe e kushtëzuar nga kufizimet e përcaktuara nga ajo administratë, si dhe nga dispozitat e paragrafit 1 (b) të këtij Neni.

Neni 6

1. Komunikimi mes Palëve Kontraktuese dhënë nga kjo Konventë do të kryhet direkt ndërmjet Administratave Doganore. Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese do të emërojnë shërbimet ose nëpunësit për këto ndërlidhje dhe do të informojnë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit për emrat dhe Adresat e këtyre Shërbimeve ose Personave. Sekretari i Përgjithshëm do t'ua komunikojë këtë informacion Palëve të tjera Kontraktuese.

2. Administrata Doganore e Palës së Kërkuar Kontraktuese, kushtëzuar nga rregullat dhe ligjet në fuqi në territorin e vet, do të marrë të gjitha masat e nevojshme për t'iu përgjigjur kërkesave për asistencë.

3. Administrata Doganore e Palës së Kërkuar Doganore do t'i përgjigjet kërkesës për asistencë, sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 7

1. Kërkesa për asistencë, sipas kësaj Konvente, duhet të kryhet normalisht me shkrim; kjo duhet të përmbajë informacionin e kërkuar dhe të shoqërohet nga dokumente të tilla që konsiderohen të dobishme.

2. Kërkesa me shkrim duhet të bëhet në një gjuhë të pranueshme nga Palët Kontraktuese të interesuara. Çdo lloj dokumenti shoqërues i kërkesës të përkthehet në një gjuhë reciprokisht të pranuar, nëse është e nevojshme.

3. Palët Kontraktuese do të pranojnë, në çdo rast, kërkesat për asistencë dhe dokumentet shoqëruese në anglisht dhe frengjisht, shoqëruar nga një përkthim në anglisht ose frengjisht.

4. Kur, për arsye urgjence të veçantë, kërkesat për asistencë nuk janë bërë me shkrim, Pala e Kërkuar Kontraktuese mund të kërkojë konfirmim me shkrim.

Neni 8

Çdo shpenzim që rrjedh nga kjo Konventë lidhur me ekspertë ose dëshmitarë do të përballohet nga Pala që bën kërkesën. Palët Kontraktuese do të heqin dorë nga çdo kërkesë për rimbursim ose çdo kosto tjetër që rrjedh nga zbatimi i kësaj Kontrate.

KREU IV

Neni 9
Dispozita të ndryshme

Këshilli dhe Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese do të koordinojnë shërbimet lidhur me parandalimin, hetimin dhe ndalimin e shkeljeve doganore për të mirëmbajtur lidhje personale dhe direkte me synim nxitjen e synimeve të përgjithshme të kësaj Konvente.

Neni 10

Për qëllimet e kësaj Konvente çdo Aneks ose Anekse të pranuara nga Palët Kontraktuese do të konsiderohen pjesë integrale të kësaj Konvente, dhe në lidhje me atë Palë Kontraktuese, çdo referencë ndaj kësaj Konvente duhet të përmbajë dhe referencën ndaj Aneksit ose Anekseve.

Neni 11

Dispozitat e kësaj Konvente nuk do të shmangin aplikimin e çdo lloj marrëveshjeje tjetër të zgjeruar të ndërsjellë, që mund të kenë ose mund të lidhin në të ardhmen Palët Kontraktuese.

KREU V

Neni 12
Roli i Këshillit dhe Komiteti Teknik Permanent

1.Këshilli do të jetë përgjegjës për administrimin dhe zhvillimin e kësaj Konvente, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

2. Për këtë qëllim Komiteti Teknik Permanent, nën autoritetin e Këshillit dhe në përputhje të çdo udhëzimi dhënë nga Këshilli, do të ketë këto funksione:

(a) T'i kalojë Këshillit propozime për ato amendamente të kësaj Konvente që mund të konsiderohen të nevojshme.

(b) Të furnizojë me opinione lidhur me interpretimin e dispozitave të Konventës.

(c) Të mirëmbajë marrëdhënie me organizatat e tjera ndërkombëtare të interesuara, dhe veçanërisht me organet kompetente të Kombeve të Bashkuara, me UNESKO-n dhe me Organizatën Ndërkombëtare të Policisë Kriminale/Interpol, për sa i takon aksioneve kundër trafikut ilegal për lëndët narkotike dhe substancat psikotrope, dhe aksionet kundër trafikut ilegal për veprat e artit, antikat dhe pasuritë e tjera kulturore.

(d) Të kryejë çdo aksion me synim zgjerimin e synimeve të përgjithshme të Konventës dhe veçanërisht për të studiuar metoda të reja dhe procedura për të lehtësuar parandalimin, hetimin dhe ndalimin e shkeljeve doganore, për të organizuar takime etj.

(e) Të kryejë aksione të tilla të drejtuara nga Këshilli në lidhje me dispozitat e Konventës.

Neni 13

Për qëllime votimi në Këshill dhe në Komitetin Teknik Permanent, çdo Aneks do të merret si Konventë e veçantë.

KREU VI

Neni 14
Dispozita Finale

Çdo mosmarrëveshje mes dy ose më tepër Palësh Kontraktuese, lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, do të zgjidhet me negocime midis tyre.

Neni 15

1. Çdo shtet anëtar i Këshillit dhe çdo shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara ose i agjencive të saj të specializuara mund të bëhet Palë Kontraktuese e kësaj Konvente (sipas amendamentit të Protokollit i cili hyri në fuqi më 27 Korrik 1989):

(a) duke e nënshkruar atë pa rezerva ratifikimi;

(b) duke depozituar një instrument të ratifikimit, pasi e ka nënshkruar atë në bazë të ratifikimit; ose

(c) duke hyrë në të.

2. Kjo Konventë do të jetë e hapur deri më 30 Qershor 1978 për nënshkrim në Drejtorinë e Këshillit në Bruksel nga shtetet e referuara në paragrafin 1 të këtij Neni. Më pas do të jetë e hapur për pranimin e tyre.

3. Çdo shtet i referuar në Paragrafin 1 të kësaj Konvente duhet, në kohën e ratifikimit, nënshkrimit ose hyrjes në këtë Konventë të specifikojë Aneksin ose Anekset që ai pranon, duke qenë e nevojshme të pranojë të paktën një Aneks. Në vazhdim, duhet të njoftojë Sekretarinë e Përgjithshme të Këshillit se pranon një ose më tepër Anekse.

4. Instrumentet e ratifikimit ose pranimit duhet të depozitohen në Sekretarinë e Përgjithshme të Këshillit.

5. Doganat ose bashkimet ekonomike mundet, së bashku me Vendet e Tyre Anëtare ose në çdo kohë që Vendet Anëtare të tyre të jenë bërë Palë Kontraktuese në këtë Konventë, gjithashtu, të bëhen Palë Kontraktuese në këtë Konventë, në përputhje me dispozitat e paragrafeve 1,2 dhe 3 të këtij Neni. Megjithatë, këto Unione nuk do të kenë të drejtën për të votuar.

Neni 16

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pasi pesë nga shtetet e përmendura në paragrafin 1 të Nenit 15 ta kenë nënshkruar Konventën pa rezerva ratifikimi ose të kenë depozituar instrumentet e ratifikimit ose të hyrjes.

2. Për çdo Palë Kontraktuese e cila ka nënshkruar Konventën pa rezervime ose ratifikime, e ka ratifikuar ose ka hyrë në të pasi pesë shtete kanë ratifikuar ose hyrë në të pa rezerva ose ratifikim, ose kanë depozituar instrumentet e ratifikimit ose të pranimit, kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pasi Pala Kontraktuese në fjalë ta ketë nënshkruar atë pa rezerva ose ratifikime ose të ketë depozituar instrumentet e veta të pranimit ose të ratifikimit.

3. Çdo aneks i kësaj Konvente do të hyjë në fuqi tre muaj pasi dy shtete të kenë pranuar Aneksin. Për çdo Palë Kontraktuese e cila në vazhdim pranon një Aneks, pasi dy shtete ta kenë pranuar atë, ky Aneks do të hyjë në fuqi tre muaj pasi Pala Kontraktuese në fjalë të ketë njoftuar pranimin e këtij Aneksi. Asnjë Aneks nuk do të hyjë në fuqi për një Palë Kontraktuese përpara se Konventa të ketë hyrë në fuqi në atë Vend Kontraktues.

Neni 17

1. Çdo Shtet mundet, që në momentin e nënshkrimit të kësaj Konvente pa rezerva ose ratifikime ose pasi ka depozituar instrumentet e ratifikimit ose pranimit, ose në çdo kohë pas kësaj të deklarojë nëpërmjet një njoftimi tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit se kjo Konventë do të zgjerohet në gjithë territorin ose një pjesë të territorit për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit ai Shtet është përgjegjës. Ky njoftim do të ketë efekt tre muaj pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit. Megjithatë, Konventa nuk do të aplikohet në territoret e përmendura në njoftim, përpara se Konventa të ketë hyrë në fuqi në shtetin në fjalë.

2. Çdo Shtet i cili ka bërë njoftim sipas paragrafit 1 të këtij Neni, duke e zgjeruar këtë Konventë në territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjës, mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit, sipas procedurave të Nenit 19 të kësaj Konvente, se territori në fjalë nuk do të vazhdojë ta zbatojë më këtë Konventë.

Neni 18

Çdo Palë Kontraktuese do të konsiderohet se ka hyrë ose ka pranuar gjithë dispozitat e Konventës ose Anekset lidhur me të, përjashtuar rastet kur në momentin e hyrjes në Konventë ose pranimit të veçantë të një Aneksi, ose në çdo kohë pas kësaj, ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit për çfarëdo rezerve lidhur me dispozitat të cilat nuk mund t'i aplikojë. Duhet të ndërmarrë ekzaminimin periodik të dispozitave për të cilat ka pasur rezerva dhe të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm, lidhur me anulimin e këtyre rezervave.

Neni 19

1. Kjo Konventë është e një kohëzgjatjeje të pacaktuar, por çdo Palë Kontraktuese mund të largohet prej saj (denoncojë) në çdo kohë pas datës së hyrjes në fuqi, sipas Nenit 16 më sipër.

2. Denoncimi duhet të njoftohet nëpërmjet një instrumenti të shkruar, depozituar tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit.

3. Denoncimi do të ketë efekt gjashtë muaj pas marrjes së dokumentit të denoncimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit.

4. Dispozitat e paragrafeve 2 dhe 3 të këtij Neni, gjithashtu do të aplikohen në respekt të Anekseve të kësaj Konvente, duke pasur mundësi që çdo Palë e cila ka hyrë në to, të ketë të drejtën në çdo datë pas hyrjes në fuqi, sipas Nenit 16 të kësaj Konvente, të distancohet nga pranimi i një ose më tepër Anekseve. Çdo Palë Kontraktuese, e cila ka deklaruar tërheqjen nga pranimi i gjithë Anekseve, do të konsiderohet se ka denoncuar Konventën.

5. Çdo Palë Kontraktuese e cila denoncon Konventën ose tërheq pranimin e një ose më tepër prej Anekseve, do të konsiderohet e lidhur me dispozitat e Nenit 5 të kësaj Konvente, për aq kohë sa ajo do të ketë në dispozicion çfarëdolloj inteligjence, dokumenti ose informacioni tjetër të marrë nën këtë Konventë.

Neni 20

1. Këshilli mund të rekomandojë amendamente në këtë Konventë.

2. Teksti i çdo amendamenti të rekomanduar në mënyrë të tillë do t'i komunikohet, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit, gjithë Palëve Kontraktuese në këtë Konventë, Shteteve të tjera Nënshkruese dhe atyre Shteteve anëtare të Këshillit që nuk janë Palë Kontraktuese në këtë Konventë.

3. Çdo amendament i propozuar dhe i komunikuar sipas paragrafit të mësipërm do të hyjë në fuqi në respekt të të gjitha Palëve Kontraktuese, tre muaj pas skadencës së periudhës prej dy vjetësh që ndjekin datën e komunikimit të amendamenteve të propozuara, kur gjatë periudhës në fjalë nuk i janë komunikuar kundërshtime për propozimet e paraqitura Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit nga ndonjë shtet, i cili është Palë Kontraktuese.

4. Nëse Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit i është komunikuar ndonjë kundërshtim për amendamentet e propozuara nga ndonjë Shtet që është Palë Kontraktuese përpara skadencës së periudhës prej dy vjetësh, specifikuar në paragrafin 3 të këtij Neni, amendamentet do të konsiderohen si të papranuara dhe nuk do të kenë efekt.

Neni 21

1. Çfarëdo Palë Kontraktuese e cila ratifikon ose hyn në këtë Konventë do të konsiderohet se ka pranuar çdo amendament në fjalë i cili ka hyrë në fuqi në datën e depozitimit të instrumenteve të vet të ratifikimit ose pranimit.

2. Çdo Palë Kontraktuese, e cila pranon një Aneks, do të konsiderohet se ka pranuar çdo amendament lidhur me këtë Aneks i cili ka hyrë në fuqi në datën në të cilën ka njoftuar këtë pranim tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit.

Neni 22

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do të njoftojë Palët Kontraktuese në këtë Konventë, Shtetet nënshkruese, Shtetet anëtare të Këshillit të cilat nuk janë Palë Kontraktuese në Konventë dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara mbi:

a) nënshkrimin, ratifikimin, pranimin dhe njoftimin sipas Nenit 15 të kësaj Konvente;

b) datën e hyrjes në fuqi të Konventës dhe të gjithë Anekseve, në përputhje me Nenin 16;

c) njoftimin e marrë në përputhje me Nenin 17;

d) denoncimin, sipas Nenit 19;

e) çdo amendament që konsiderohet të jetë pranuar, në përputhje me Nenin 20 dhe datën e hyrjes në fuqi.

Neni 23

Pas hyrjes në fuqi, kjo Konventë do të regjistrohet në Sekretariatin e Kombeve të Bashkuara, në përputhje me Nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Dëshmitarë për sa më sipër, të nënshkruarit, të autorizuar për këtë, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Kryer në Nairobi, më 9 Qershor 1977, në gjuhën angleze dhe frënge, duke qenë të dyja tekstet barazisht autentike, në një origjinal të vetëm i cili do të depozitohet tek Sekretari i Përgjithshëm i cili do t'u transmetojë kopje të certifikuara gjithë Shteteve të përmendura në paragrafin 1 të Nenit 15 të kësaj Konvente.

ANEKS I

Asistencë nga një Administratë Doganore, sipas iniciativës së vet

1. Administrata Doganore e një Pale Kontraktuese, me iniciativën e vet, do t'i komunikojë Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, e cila ka interes, çfarëdolloj informacioni të një natyre thelbësore, e cila është gjetur gjatë aktivitetit të vet normal dhe që jep shkaqe të mira për të besuar se në territorin e një pale Kontraktuese do të kryhet një shkelje serioze doganore. Informacioni i cili do të komunikohet të përmbajë, veçanërisht, lëvizjen e personave, mallrave dhe mjeteve të transportit.

2. Administrata Doganore e një Pale Kontraktuese do t'i komunikojë kur e sheh të përshtatshme, sipas iniciativës së vet Administratës Doganore të Palës tjetër Kontraktuese dokumente, raporte, regjistrime evidencash ose kopje të certifikuara lidhur me të në mbështetje të informacionit të transmetuar sipas paragrafit 1.

3. Administrata Doganore e një Pale Kontraktuese, me iniciativën e vet do t'i komunikojë Administratës Doganore të një Pale tjetër Kontraktuese e cila ka interes direkt, çdolloj informacioni i cili duket se është i një interesi material për të, lidhur me shkeljet doganore, dhe, veçanërisht, lidhur me mjetet ose metodat e reja që përdoren për të kryer këto lloj shkeljesh.

ANEKS II

Asistencë, sipas kërkesës, lidhur me përcaktimin e detyrimeve dhe taksave të importit ose eksportit

1. Sipas kërkesës së një Administrate Doganore të një Pale Kontraktuese e cila ka arsye të forta për të besuar se në vendin e vet është kryer shkelje serioze doganore, Administrata Doganore e Palës Kontraktuese të cilës i është kërkuar asistencë do të komunikojë gjithë informacionin i cili mund të ndihmojë për të siguruar përcaktimin e saktë të detyrimeve dhe taksave të importit ose eksportit.

2. Një Palë Kontraktuese do të konsiderohet se ka përmbushur detyrimet lidhur me këtë, nëse p.sh. ka komunikuar, siç duhet në përgjigje të një kërkese informacionin e mëposhtëm ose dokumentet e nevojshme për të:

a) lidhur me vlerën e mallrave për qëllime doganore: faturat tregtare të paraqitura në doganat e vendit të eksportit ose importit ose kopje të këtyre faturave, të certifikuara ose jo nga Dogana, siç mund ta kërkojnë rrethanat, dokumentet që tregojnë çmimet momentale të importit ose eksportit, kopje të deklaratës së vlerës të kryer në importimin ose eksportimin e mallrave, katalogët e tregut, listat e çmimeve, etj., të publikuara në vendin e eksportit ose të importit;

b) lidhur me klasifikimin tarifor të mallrave, analizat e kryera nga shërbimet laboratorike për të vendosur klasifikimin tarifor të mallrave, përshkrimin tarifor të deklaruar gjatë importit ose eksportit;

c) lidhur me origjinën e mallrave, deklaratën e origjinës kryer gjatë eksportit, kur kërkohet një deklaratë e tillë, statusin Doganor të mallrave në vendin e eksportimit (tranzit doganor, magazinë doganore, pranim i përkohshëm, zonë e lirë, qarkullim i lirë, eksport për rikthim, etj).

ANEKS III

Asistencë, sipas kërkesës, lidhur me kontrollet

Me kërkesë të Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e Palës tjetër Kontraktuese do t'i komunikojë asaj Administrate Doganore informacion lidhur me çështjet e mëposhtme:

a) Autenticitetin e dokumenteve zyrtare të prodhuar në mbështetje të një deklarate Doganore që i është dhënë Autoriteteve Doganore të Palës Kërkuese.

b) Nëse mallrat e importuara në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese janë eksportuar në mënyrë të ligjshme nga territori i një Pale tjetër Kontraktuese.

c) Nëse mallrat e eksportuara nga territori i Palës Kërkuese Kontraktuese kanë qenë importuar në mënyrë të ligjshme në territorin e Palës Kontraktuese që i kërkohet informacion.

ANEKS IV
Asistencë, sipas kërkesës, lidhur me survejimet

Sipas kërkesës së Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e një Pale tjetër Kontraktuese, për aq sa i lejon kompetenca dhe mundësia, do të kryejë survejim special për një periudhë të caktuar kohe mbi:

a) lëvizjet, veçanërisht për hyrjet brenda dhe daljet jashtë territorit të vet, për persona të veçantë, për të cilët ka arsye të besohet se janë lidhur profesionalisht apo vazhdimisht me shkelje doganore në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese;

b) lëvizjen e mallrave të veçanta të cilat janë raportuar nga Administrata Doganore e Palës Kontraktuese Kërkuese se shkaktojnë rritje të Trafikut ilegal të importit në drejtim ose nga territori i asaj Pale Kontraktuese;

c) vende të veçanta ku janë grumbulluar mallra, të cilat japin shkaqe për të arsyetuar se ato mallra do të përdoren për një import të paligjshëm në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese

d) mjete lëvizëse të veçanta, anije, avione ose mjete të tjera transporti për të cilat besohet me arsye se mund të përdoren për të kryer një shkelje doganore në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese;

dhe do t'i dërgojë një raport për këto Administratës Doganore të Palës Kontraktuese Kërkuese.

ANEKS V
Kërkime dhe njoftime, sipas kërkesës, për interes të Palës tjetër Kontraktuese

1. Sipas kërkesës së Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e Palës tjetër Kontraktuese, kushtëzuar nga Ligjet dhe rregullat në fuqi në territorin e vet, do të bëjë kërkime për të marrë të dhënat lidhur me një shkelje Doganore nën hetim në territorin e Palës Kërkuese Kontraktuese, dhe do të marrë deklarata nga çdo person i konsideruar i lidhur me këtë shkelje ose nga dëshmitarë ose ekspertë, dhe do t'ua dërgojë rezultatet e kërkimeve, si dhe dokumente ose evidenca të tjera, Administratës Doganore të Palës Kërkuese Kontraktuese.

2. Sipas kërkesës me shkrim të Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e një Pale tjetër Kontraktuese, kushtëzuar nga Ligjet dhe rregullat në fuqi në territorin e vet, do të njoftojë personat që lidhen me këtë, dhe që janë rezidentë në territorin e vet ose do t'i ketë njoftuar nëpërmjet autoriteteve kompetente për çfarëdolloj aksioni ose vendimi të marrë nga Pala Kontraktuese Kërkuese, lidhur me çfarëdolloj çështje që ndodhet brenda fushës së veprimit të kësaj Konvente.

ANEKS VI
Paraqitja përpara gjyqit ose Tribunaleve jashtë shtetit e zyrtarëve të Doganës

Kur nuk mjafton që evidenca të dërgohet vetëm në formën e një deklarate me shkrim, sipas kërkesës së Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e Palës tjetër Kontraktuese, për aq sa i lejon mundësia, do të autorizojë nëpunësit e vet të paraqiten përpara gjyqit ose Tribunaleve në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese si dëshmitarë ose ekspertë në një çështje të shkeljeve doganore. Kërkesa për paraqitje do të specifikojë, se veçanërisht në çfarë çështje dhe në çfarë pozicioni do të dëgjohet ky nëpunës. Administrata Doganore e Palës Kontraktuese që pranon

kërkesën, do të deklarojë, në autorizimin e paraqitjes, çfarëdo limiti në të cilat nëpunësit e vet do të detyrohen të japin evidencat.

ANEKS VII
Prezenca e Zyrtarëve të Doganës së një Pale Kontraktuese në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese

1. Sipas kërkesës me shkrim të Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese që po investigon për një shkelje të caktuar doganore, Administrata Doganore e një Pale tjetër Doganore, kur e sheh të nevojshme, do të autorizojë zyrtarë të caktuar specifikisht, të deleguar nga Pala Kontraktuese Kërkuese, të konsultohen në zyrat e veta me librat e nevojshëm, regjistrat dhe dokumentet e tjera ose të dhënat e ruajtura në këto zyra, të marrin kopje të tyre, ose pjesë të informacioneve ose partikularëve që lidhen me atë shkelje.

2. Në aplikim të dispozitave të paragrafit 1 më sipër zyrtarëve të Palës Kontraktuese Kërkuese do t'i jepet gjithë asistenca e mundshme dhe bashkëpunimi për të lehtësuar investigimet e tyre.

3. Sipas kërkesës me shkrim të Administratës Doganore të në Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e një Pale tjetër Kontraktuese, kur konsiderohet e përshtatshme, do të autorizojë zyrtarët e administratës kërkuese të jenë prezent në territorin e Palës Kontraktuese që i kërkohet asistencë, lidhur me kërkimet ose raportin zyrtar për një shkelje Doganore që i intereson Palës Kontraktuese.

ANEKS VIII
Pjesëmarrje në investigimet jashtë

Kur shihet e përshtatshme nga të dyja Palët Kontraktuese, zyrtarët e Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, sipas kërkesës së një Pale tjetër Kontraktuese, do të marrin pjesë në investigimet jashtë që kryen në territorin e asaj Pale tjetër Kontraktuese.

ANEKS IX
Grumbullimi i informacionit

1. Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese do t'i komunikojnë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit informacionin e specifikuar më poshtë, për aq kohë sa kjo përbën interes ndërkombëtar.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do të institucionalizojë dhe mbajë vazhdimisht një indeks qendror për informacionin e komunikuar atij nga Palët Kontraktuese dhe do të përdorë informacion prej saj për të përgatitur përmbledhje dhe studime mbi tendencat e reja dhe të rinovuara mbi Mashtrimet Doganore. Ai, periodikisht, do ta rifreskojë indeksin për të eliminuar informacione të cilat, për mendimin e tij, janë të panevojshme ose kanë kaluar kohën.

3. Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese, sipas kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit dhe, kushtëzuar nga dispozitat e tjera të kësaj Konvente dhe këtij Aneksi, do t'i japin Sekretarit të Përgjithshëm informacione të tilla që mund të jenë të nevojshme për të përgatitur këto përmbledhje dhe studime të përmendura në paragrafin 2 të këtij Aneksi.

4. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do të shpërndajë tek nëpunësit ose shërbimet e emëruara nga Palët Kontraktuese informacion specifik që përmbahet në indeksin qendror, në atë sasi që ai e konsideron këtë shpërndarje të dobishme, si dhe përmbledhje dhe studime të përmendura në paragrafin 2 të këtij Aneksi.

5. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit, sipas kërkesës, do të furnizojë Palët Kontraktuese me çfarëdolloj informacioni tjetër që ai ka në dispozicion, sipas këtij Aneksi.

6. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do të respektojë çdo kufizim që Pala Kontraktuese ka kërkuar prej tij kur i ka dhënë informacionin.

7. Një Palë Kontraktuese që ka dërguar informacion ka të drejtë të kërkojë që në vazhdim ky të fshihet nga indeksi qendror dhe nga çfarëdolloj regjistri të themeluar nga Palët Kontraktuese me të cilat ka komunikuar dhe se nuk do të përdoret më ky informacion.

PJESA I:
PERSONAT

Seksioni I. Kontrabanda

8. Njoftimet sipas këtij Seksioni do të përmbajnë informacion lidhur me:

a) personat e dënuar përfundimisht për kontrabandë; dhe,

b) kur është e përshtatshme, personat e dyshuar për kontrabandë ose të kapur në akt kontrabande në territorin e Palës Kontraktuese, duke bërë njoftimin, megjithëse procesi penal mund të mos jetë kompletuar, e cila nënkupton se kur Palët Kontraktuese nuk njoftojnë emrat dhe përshkrimin e personave të implikuar, sepse kjo ndalohet nga ligjet e tyre kombëtare, ata gjithsesi duhet të bëjnë një njoftim i cili të përmbajë sa më shumë nga të dhënat që janë në listë në këtë Seksion.

Në parim, informacioni i njoftuar duhet të kufizohet në shkeljet që kanë rezultuar ose kanë çuar në burgosje ose gjoba që tejkalojnë ekuivalentin e 2000 US $.

9. Informacioni i dërguar të përmbajë sa më shumë të jetë e mundur faktet e mëposhtme:

(A) Person fizik

a) Mbiemri;

b) Emri;

c) Emri i dhënë (nëse përdoret);

d) Pseudonimi;

e) Profesioni;

f) Adresa;

g) Datëlindja dhe Vendlindja

h) Shtetësia/Kombësia;

ij) Vendi i rezidencës dhe vendet e vizituara në 12 muajt e fundit;

k) Tipi dhe numri i letrave të identifikimit, duke përfshirë vendin dhe datën e lëshimit

I. Përshkrimi fizik

1. Seksi;

2. Gjatësia;

3. Pesha;

4. Konstrukti;

5. Flokët;

6. Sytë;

7. Kompleksiteti;

8. Shenja dalluese ose femërore;

m) Të dhëna të përmbledhura për shkeljen (duke përfshirë të dhëna për tipin, sasinë dhe origjinën e mallrave që janë përfshirë në shkelje, prodhuesi, transportuesi dhe ngarkuesi) dhe kushtet të cilat kanë çuar në zbulimin;

n) Natyra dhe sasia e dënimeve ose gjobave të vëna;

o) Vëzhgime të tjera, duke përfshirë gjuhët që janë folur dhe (nëse është e mundur) ndonjë shkelje të kaluar të regjistruar;

p) Palën Kontraktuese që jep informacionin (duke përfshirë numrin e referencës).

(B) Personat juridikë (firmat)

a) Emri;

b) Adresa;

c) Emrat e drejtuesve kryesorë ose nëpunësve të firmës kundër të cilëve është kryer ndjekje ligjore, dhe nëse është e mundur të identifikohen të dhëna, siç tregohet në Pjesën (a), Pikat (A)-(1).

d) Kompania ndërkombëtare e lidhur;

e) Natyra e biznesit që kryen;

f) Natyra e shkeljes;

g) Të dhëna për shkeljen (duke përfshirë prodhuesin, transportuesin dhe dërguesin) dhe kushtet që çuan në zbulimin e shkeljes;

h) Madhësia e dënimit;

ij) Vëzhgime të tjera, duke përfshirë (nëse ka mundësi) ndonjë shkelje tjetër e regjistruar;

k) Pala Kontraktuese që dërgon informacionin (duke përfshirë numrin e referencës);

10.Si rregull i përgjithshëm, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do të shpërndajë

informacionin lidhur me personat fizike të paktën në vendet e shtetësisë kombësisë dhe rezidencës, si dhe në vendet që personi fizik në fjalë ka vizituar gjatë 12 muajve të fundit.

Seksioni II. Mashtrime Doganore të tjera veç kontrabandës

11. Njoftimet nën këtë Seksion do të përmbajnë informacion lidhur me:

a) personat përfundimisht të dënuar për shkelje doganore të tjera veç kontrabandës;

b) kur është e mundur, personat e dyshuar për mashtrime të tilla, edhe ata për të cilët procesi penal nuk ka përfunduar ende,

që duhet kuptuar se kur Palët Kontraktuese mohojnë dhënien e emrave dhe përshkrimeve të personave të implikuar sepse ky njoftim ndalohet nga ligji i tyre kombëtar, ata gjithsesi bëjnë një njoftim i cili përmban sa më shumë nga të dhënat që janë në listë në këtë Seksion.

Në parim, informacioni i njoftuar do të kufizohet në shkelje të cilat kanë rezultuar ose kanë çuar në burgosje ose gjoba që kalojnë ekuivalentin e 2.000 US $

12. Informacioni që do të dërgohet, të përmbajë sa më shumë që të jetë e mundur, të dhënat e mëposhtme:

a) Emri (ose emri i firmës) dhe adresa;

b) Emrat dhe të dhëna identifikuese për drejtuesit e firmës ndaj të cilëve është bërë një ndjekje penale;

c) Lloji i mallrave;

d) Vendi i origjinës;

e) Kompania ndërkombëtare e lidhur;

f) Emri dhe adresa e shitësit;

g) Emri dhe adresa e transportuesit;

h) Emrat dhe adresat e partnerëve të tjerë të implikuar (agjentë blerës apo shitës, ndërmjetës të tjerë, etj);

i) Portet apo vendet e tjera ku mallrat u eksportuan;

k) Të dhëna të shkurtra të shkeljes dhe kushtet që çuan në zbulimin e saj;

l) Sasia e dënimit dhe deficiti i krijuar në të ardhurat që do mblidheshin, nëse ka;

m) Vëzhgime të tjera që përfshijnë (nëse ka) ndonjë shkelje tjetër të regjistruar;

n) Palën Kontraktuese që jep informacionin (duke përfshirë numrin e referencës).

PJESA II:
METODA TË KONTRABANDËS DHE MASHTRIME TË TJERA, DUKE PËRFSHIRË MASHTRIM ME FALSIFIKIM, DUPLIKIM FATURASH DHE FATURA TË GËNJESHTËRTA

13. Njoftimet nën këtë Pjesë do të japin informacion lidhur me metodat e kontrabandës dhe mashtrimet e tjera, duke përfshirë metodat e fshehjes, mashtrimit me falsfikim, duplikim faturash, fatura të gënjeshtërta, në të gjitha rastet e interesave të rëndësishme ndërkombëtare. Palët Kontraktuese do të raportojnë çdo përdorim të medotave të reja të kontrabandës dhe mashtrimeve të tjera si metoda të reja dhe të pazakonta ose të mundshme në mënyrë që të zbulohen tendencat e reja në këtë fushë.

14. Informacioni që do të dërgohet të përmbajë sa më shumë që të jetë e mundur, të dhënat e mëposhtme:

a) Përshkrimin e metodave të kontrabandës dhe mashtrimeve të tjera, duke përfshirë mashtrim me fshehje, falsifikim ose fatura të gënjeshtërta. Nëse është e mundur, përshkrimin (modeli, pamja, numrat e regjistrimit) të mjeteve të transportit të përdorura. Kur është e mundur, të dhëna nga targat ose certifikatat e kontenierëve ose mauneve, format e të cilave janë aprovuar nga një konventë ndërkombëtare, dhe informacione mbi dëmtimin e plumbosjeve, pjesëve të vulosura, pjesëve metalike dhe pjesëve të tjera të kontenierëve apo mjeteve.

b) Përshkrim, nëse është e mundur, të vendit të fshehjes, duke përfshirë nëse është e mundur një fotografi ose skicë.

c) Përshkrimi i mallrave të fshehura.

d) Natyra ose përshkrimi i falsifikimit, faturave të gënjeshtërta, të duplikuara, mënyra e përdorimit të këtyre falsifikimeve, mashtrimeve, duplikimeve të gënjeshtërta, vulave doganore, targave fallco etj.

e) Vëzhgime të tjera duke përfshirë rrethanat që çuan në zbulim

f) Pala Kontraktuese që dërgoi informacionin (duke përfshirë numrin e referencës).

PJESA III:
MJETET LUNDRUESE TË PËRFSHIRA NË KONTRABANDË

15. Njoftimet nën këtë pjesë do të përmbajnë informacion lidhur me mjetet lundruese, të të gjitha tipeve, që janë implikuar në kontrabandë, por duhet të kufizohen, në parim, në rastet të cilat konsiderohen se janë të një interesi ndërkombëtar.

16. Për sa të jetë e mundur dhe aq sa e lejon ligji kombëtar, informacioni i dërguar duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

a) Emri dhe identifikime të shkurtra të mjetit (S.S, M.V, tonazhi, silueta, etj);

b) Emri dhe adresa e pronarit;

c) Flamuri;

d) Porti i regjistrimit, dhe nëse është i ndryshëm, porti vendas;

e) Emri dhe shtetësia/kombësia (dhe nëse është e mundur, oficerët kryesorë);

f) Natyra e shkeljes, duke përfshirë përshkrimin e mallrave të kapura;

g) Përshkrim, nëse është e mundur, të vendit të fshehjes, (duke përfshirë nëse është mundur fotografi ose skicë) dhe rrethanat e tjera që çuan në zbulim;

h) Vendi i origjinës së mallrave të kapura;

ij) Porti i parë hyrës;

k) Porti final i destinacionit;

l) Portet ku ndaloi midis (ij) dhe (k);

m) Vëzhgime të tjera (numri i rasteve në të cilat i njëjti mjet lundrues, kompani detare, karter ose operatorë të tjerë detarë kanë qenë të implikuara në kontrabandë etj.)

n) Pala Kontraktuese që dërgon informacionin (duke përfshirë numrin e referencës)

ANEKS X
Asistencë në aksionet kundër kontrabandës së lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope

1. Dispozitat e këtij Aneksi nuk do të përjashtojnë aplikimin e masave në fuqi në nivel kombëtar për koordinimin e aktiviteteve të autoriteteve të ndryshëm kompetente për të ndërmarrë aksione të tilla kundër abuzimit me lëndë narkotike dhe substancave të tjera psikotrope. Gjithashtu këto nuk do të pengojnë, por përmbushin, zbatimin e Dispozitave të Konventës së Vetme mbi Lëndët Narkotike 1961, dhe Konventës së 1971 mbi Substancat Psikotrope, nga Palët në këto Konventa të cilat kanë pranur gjithashtu këtë Aneks.

2. Dispozitat e këtij Aneksi që kanë të bëjnë me kontrabandën e lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope, do të aplikohen sa herë të jetë e përshtatshme dhe në mundësinë që japin kompetencat e Administratës Doganore, gjithashtu për operacionet financiare të ndërmarra në lidhje me këtë kontrabandë.

Shkëmbimi i informacionit nga Administratat Doganore sipas iniciativës së vet.

3. Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese, me iniciativën e vet dhe pa vonesë, do t'i komunikojnë Administratave të tjera Doganore të cilat mund të jenë vetë të interesuara, çdo informacion që ka, lidhur me:

a) veprime që dihen ose dyshohen që kanë kryer, ose duket se kanë bërë kontrabandë të lëndëve narkotike ose substancave psikotrope;

b) personat që dihet se janë përfshirë, ose informacione lidhur me persona që i është komunikuar sipas ligjit, persona që janë përfshirë në pjesëmarrje në veprimet e referuara më sipër në paragrafin a) më sipër, dhe mjete transporti anije, avionë ose mjete të tjerë transportues të përdorur ose të dyshuar që janë përdorur për veprime të tilla;

c) mjete dhe metoda të tjera të përdorura për kontrabandën e lëndëve narkotike ose të substancave psikotrope;

d) produkte që janë zhvilluar ose përdorur për herë të parë si lëndë narkotike ose substanca psikotrope dhe të cilat janë subjekt kontrabande.

Asistencë, sipas kërkesës lidhur me survejimet.

4. Sipas kërkesës së Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e një Pale tjetër Kontraktuese, në kuadrin e kompetencave dhe mundësive të saj, do të mirëmbajë survejim special për një periudhë të caktuar kohe mbi:

a) lëvizjet, veçanërisht hyrjet dhe daljet nga territori i vet i personave të veçantë që besohet me arsye se janë përfshirë profesionalisht ose në mënyrë të vazhdueshme në kontrabandën e lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese;

b) lëvizjen e lëndëve narkotike ose substancave psikotrope, të cilat janë raportuar nga Administrata Doganore e Palës Kontraktuese Kërkuese se kanë shkaktuar rritje të trafikut ilegal të importit drejt ose nga territori i asaj Pale Kontraktuese;

c) vende të veçanta ku janë ndërtuar grumbullime të lëndëve narkotike ose substancave psikotrope, të cilat japin shkaqe për të besuar se ato do të përdoren për import ilegal në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese;

d) mjete të veçanta, anije, avionë dhe mjete të tjera për të cilat besohet me arsye se janë përdorur për kontrabandë të lëndëve narkotike ose substancave psikotrope në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese;

dhe do t'i komunikojë një raport, lidhur me këtë, Administratës Doganore të Palës Kontraktuese Kërkuese.

Kërkime, sipas kërkesës, për interes të një Pale tjetër Kontraktuese.

5. Sipas kërkesës së Administratës Doganore të Palës Kontraktuese Kërkuese, Administrata Doganore e Palës tjetër Kontraktuese, kushtëzuar nga ligjet dhe rregullat në fuqi në territorin e vet, do të bëjë kërkime për të marrë fakte lidhur me kontrabandën e lëndëve narkotike ose substancave psikotrope nën investigim në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese dhe të marrë deklarata nga çfarëdolloj personi të lidhur me këtë kontrabandë, ose nga dëshmitarë dhe ekspertë; dhe t'i komunikojë rezultatet e kërkimit, si dhe ndonjë dokument ose evidencë, Administratës Doganore të Palës Kontraktuese Kërkuese.

Aksione nga oficerët e Doganës së një Pale Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

6. Kur nuk mjafton që evidencat të jepen vetëm në mënyrën e një deklarate me shkrim, sipas kërkesës së Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administata Doganore e Palës tjetër Kontraktuese, në kuadrin e mundësive të veta, do të autorizojë zyrtarët e saj të paraqiten përpara gjyqit ose tribunalëve në territorin e Palës Kërkuese Kontraktuese si dëshmitarë ose ekspertë në çështjet e kontrabandës së lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope. Kërkesa për paraqitje do të specifikojë, veçanërisht për çfarë çështje dhe në çfarë pozicioni do të dëgjohen këta zyrtarë. Administrata Doganore e Palës Kontraktuese që pranon kërkesën dhe autorizimin e paraqitjes, do të deklarojë limitet të cilat zyrtarët e saj do të përmbushin për të dhënë faktet.

7. Sipas kërkesës së shkruar të Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e një Pale tjetër Kontraktuese, kur shihet e përshtatshme dhe në kufijtë e kompetencave dhe mundësive të veta, do të autorizojë zyrtarët e Palës Kontraktuese për t'u prezantuar në territorin e Palës Kontraktuese që i kërkohet, lidhur me kërkimet ose për raportimet zyrtare lidhur me kontrabandën e lëndëve narkotike ose të substancave psikotrope që janë shqetësim për Palën Kontraktuese Kërkuese.

8. Kur shihet e mundur nga të dyja Palët Kontraktuese, dhe kushtëzuar nga ligjet dhe rregullat në fuqi në territorin e vet, zyrtarët e Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, sipas kërkesës së një Pale tjetër Kontraktuese, do të marrin pjesë në investigime të kryera në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

GRUMBULLIMI I INFORMACIONIT

9. Administrata Doganore e Palëve Kontraktuese do t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit, kur ky informacion është i një interesi të përbashkët, informacionet e specifikuara këtu.

10. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do të institucionalizojë dhe do të mbajë të rifreskuar një indeks qendror të informacionit, komunikuar atij nga Palët Kontraktuese dhe do të përdorë informacion prej tij për të përgatitur përmbledhje dhe studime mbi tendencat e reja dhe të vazhdueshme për kontrabandën e lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope. Ai do ta rishikojë

periodikisht këtë indeks për të eleminuar informacionet të cilat, sipas opinionit të tij, kanë kaluar dobishmërinë ose kanë dalë jashtë kohe.

11. Administrata Doganore e Palëve Kotraktuese, sipas kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit dhe varur nga dispozitat e tjera të kësaj Konvente, do të furnizojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit me informacione të tilla, që mund të jenë të nevojshme për të përgatitur përmbledhjet dhe studimet e referuara në paragrafin 10 të këtij Aneksi.

12. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do t'i shpërndajë shërbimeve ose zyrtarëve të caktuar nga Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese informacion specifik që përmbahet në indeksin qendror, aq sa e konsideron ai të dobishëm, si dhe përmbledhje dhe studime të përmendura në paragrafin 10 të këtij Aneksi.

13. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit, nëse nuk kundërshtohet nga Pala Kontraktuese që jep informacionin, gjithashtu, do t'u shpërndajë shërbimeve ose zyrtarëve të emëruar nga anëtarët e tjerë të Këshillit, trupave kompetente të Kombeve të Bashkuara, Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale/Interpol dhe organizatave të tjera me të cilat janë bërë marrëveshje lidhur me këto çështje, çfarëdolloj informacioni lidhur me kontrabandën e lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope të përmbajtura në indeksin qendror, në limitet që ai i konsideron këto shpërndarje të dobishme, si dhe përmbledhje ose studime që ai mund të ketë përgatitur nën këtë temë sipas paragrafit 10 të këtij Aneksi.

14. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit, sipas kërkesës, do të furnizojë Palët Kontraktuese që kanë pranuar këtë Aneks me çfarëdolloj informacioni tjetër që ai ka në dispozicion lidhur me grumbullimin e informacionit të parashikuar në këtë Aneks.

INDEKSI QENDROR, PJESA I: PERSONAT

15. Njoftimet nën këtë Pjesë të Treguesit Qendror do të japin informacion lidhur me:

a) personat përfundimisht të dënuar për kontrabandë; dhe

b) kur është e mundur, persona të dyshuar për kontrabandë ose të përfshirë në akte kontrabande në territorin e Palës Kontraktuese që bën njoftimin, megjithëse procedimet penale mund të mos kenë përfunduar,

që kuptohet si: kur Palët Kontraktuese shmangen nga dhënia e njoftimit për emrat dhe përshkrimet e personave të implikuar në raste të tilla sepse njoftime të tilla janë të ndaluara nga legjislacioni i tyre kombëtar, ata gjithsesi duhet të bëjnë njoftime që të përmbajnë sa më shumë që të jetë e mundur nga të dhënat e përmendura në listën e kësaj Pjese të Indeksit Qendror.

16. Informacioni që do të dërgohet, të përmbajë sa më shumë që të jetë e mundur, të dhënat e mëposhtme:

a) Mbiemrin;
b) Emrin;
c) Emrin e dhënë (nëse ka);
d) Pseudonimet;
e) Profesionin;
f) Adresa (e tanishme);
g) Datëlindja dhe vendlindja;
h) Shtetësia/Kombësia;
ij) Vendi i rezidencës dhe vendet e vizituara gjatë 12 muajve të fundit;
k) Tipi dhe numri i letrave të identifikimit, duke përfshirë datën dhe vendin e lëshimit;
l) Përshkrimi fizik;
1. Seksi;
2) Gjatësia;
3) Pesha;
4) Konstrukti;
5) Flokët;
6) Sytë;
7) Kompleksi;
8) Shenja dalluese ose femërore.
m) Përshkrime të shkurtra të shkeljes (duke përfshirë tipin, sasinë dhe origjinën e mallrave të

përfshira në shkelje, prodhuesi, transportuesi dhe ndërmjetësi) si dhe konditat që çuan në zbulimin e shkeljes;

n) Natyra dhe sasia e shkeljeve ose dënimeve të dhëna;

o) Vëzhgime të tjera, duke përfshirë gjuhën e folur dhe nëse është e mundur shkeljet e kaluara të regjistruara;

p) Palën Kontraktuese që jep informacionin (duke përfshirë numrin e referencës).

17. Si rregull i përgjithshëm, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do të shpërndajë informacion lidhur me Pjesën I të Indeksit Qendror të paktën në vendet e Kombësisë/Shtetësisë, rezidencës dhe vendeve që ka vizituar ky person në 12 muajt e fundit.

INDEKSI QENDROR, PJESA II: METODAT

18. Njoftimet nën këtë Pjesë të Indeksit Qendror do të japin informacion lidhur me metodat e kontrabandës së lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope, duke përfshirë metodat e fshehjes, në të gjitha rastet e interesave të rëndësishme ndërkombëtare. Palët Kontraktuese do të raportojnë çdo përdorim të metodave të njohura të kontrabandës, si dhe metoda të pazakonta ose të mundshme në mënyrë që të zbulohen tendencat e kohës në këtë fushë.

19. Informacioni që do të dërgohet të përmbajë sa më shumë të jetë e mundur, të dhënat e mëposhtme:

a) Përshkrim të metodave të kontrabandës. Nëse ka mundësi, përshkrimi (ndërtimi, marka, modeli, numri i regjistrimit, etj), i çfarëdolloj mjeti transporti të përdorur. Kur është e mundur, të dhëna nga targa e aprovuar e certifikatës së Konteinierit apo mjetit, dizenjot e të cilave janë aprovuar nën një Konventë Ndërkombëtare, çfarëdolloj informacioni mbi dëmtimet e vulave, pjesëve metalike, pajisjeve vulosëse ose pjesëve të tjera të kontenierëve ose mjeteve.

b) Përshkrim, nëse ka mundësi, të vendit të fshehjes, duke përfshirë nëse është e mundur një fotografi ose skicë.

c) Përshkrim i mallrave në fjalë.

d) Vëzhgime të tjera duke përfshirë rrethanat që çuan në zbulim.

e) Palën Kontraktuese që jep informacionin (duke përfshirë numrin e referencës).

INDEKSI QENDROR, PJESA III: MJETET LUNDRUESE TË PËRFSHIRA NË KONTRABANDË

20. Njoftimet nën këtë Pjesë të Treguesit Qendror do të përmbajnë informacion lidhur me mjetet lundruese të të gjitha tipeve, të cilat janë përfshirë në kontrabandën e lëndëve narkotike ose substancave psikotrope, por duhet të kufizohet, në parim, në rastet të cilat konsiderohen se janë të një interesi ndërkombëtar.

21. Për aq sa lejon ligji kombëtar dhe sa të jetë e mundur, informacioni i dërguar do të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

a) Emri dhe identifikime të përmbledhura të mjetit lundrues (S.s., M.V., tonazhi, silueta etj.);

b) Emri dhe adresa e pronarit, karter;

c) Flamuri;

d) Porti i regjistrimit, dhe nëse është i ndryshëm, porti vendas;

e) Emri dhe shtetësia; kombësia e kapitenit (dhe nëse është e mundur, oficerët kryesorë);

f) Natyra e shkeljes, duke përfshirë përshkrimin e mallrave të kapura;

g) Përshkrimi nëse është e mundur i vendit të fshehjes (duke përfshirë nëse është e mundur një fotografi ose skicë) dhe përshkrim të rrethanave që çuan në zbulim;

h) Vendi i origjinës së mallrave të kapura;

i) Porti i parë i ankorimit;

k) Porti final i destinacionit;

l) Portet ku ka ndaluar ndërmjet i) dhe k);

m) Vëzhgime të tjera (numri i rasteve në të cilat e njëjta anije, linjë detare, karter ose operator tjetër detar është përfshirë në kontrabandë, etj.);

n) Pala Kontraktuese që jep informacionin (duke përfshirë numrin e referencës).

ANEKS XI

Asistencë në aksionet kundër kontrabandës së veprave të artit, antikave dhe pasurive të tjera kulturore

1. Dispozitat e këtij Aneksi aplikohen për veprat e artit, antikat dhe "pasuritë e tjera kulturore", të cilat në bazë besimi fetar, etj, janë të një rëndësie për arkeologjinë, parahistorinë, historinë, literaturën, artin dhe shkencën, sipas parimeve të paragrafit (a)-(k) të nenit 1 të Koventës UNESKO lidhur me kufizimin dhe parandalimin e transportit ilegal, eksportin dhe transportimin e vlerave kulturore (Paris, 14 nëntor 1970), për aq kohë sa vepra e artit, antikat dhe pasuritë e tjera kulturore të jenë subjekt kontrabande. Ato nuk përjashtojnë aplikimin e masave kombëtare mbi kooperimin me shërbimet kombëtare për mbrojtjen e pasurive kulturore, dhe në fushën e doganave, përmbushin zbatimin e dispozitave të Konventës së UNESKO-s, nga Palët Kontraktuese për këtë Konventë të cilat gjithashtu kanë pranuar këtë Aneks.

2. Dispozitat e këtij Aneksi lidhur me kontrabandën e veprave të artit, antikave dhe pasurive të tjera kulturore, në kuadrin e kompetencave të Administratës Doganore dhe sa herë të jetë e mundur, do të zbatohen gjithashtu për operimet financiare të ndërmarra lidhur me këtë kontrabandë.

Shkëmbimi i informacionit nga Administratat Doganore me iniciativën e vet.

3. Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese, me iniciativën e vet dhe pa vonesë, do t'i komunikojnë Administratave të tjera Doganore që mund të jenë direkt të interesuara, çdo informacion që kanë në dispozicion lidhur me:

a) operacionet që dihen ose dyshohen, që përbëjnë, ose duket se kanë sjellë, kontrabandë të veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore;

b) personat që dihet se janë përfshirë, ose për aq sa, informacionet që kanë të bëjnë me këta persona mund të komunikohen në përputhje me ligjin kombëtar, personat e dyshuar që janë përfshirë në veprimet e referuara në paragrafin a) më lart, si dhe mjete lundrimi, anije, avionë dhe mjete të tjera transporti të përdorura ose që janë dyshuar se janë përdorur për këto operacione;

c) mjete ose metoda të reja të përdorura për kontrabandën e veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore.

Asistencë, sipas kërkesës, lidhur me survejimet;

4. Sipas kërkesës së Administratës Doganore të Palës Kontraktuese, Administrata Doganore e një Pale tjetër Kontraktuese, në kufirin e mundësive dhe kompetencave të veta, do të kryejë survejim special për një periudhë të caktuar kohe mbi:

a) lëvizjet, veçanërisht gjatë hyrjes ose daljes nga territori i vet i personave të veçantë që besohet se janë përfshirë, profesionalisht ose vazhdimisht, në kontrabandën e veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese;

b) lëvizjet e veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore të cilat janë raportuar nga Administrata Doganore e një Pale Kontraktuese Kërkuese se kanë shkaktuar rritje serioze të trafikut ilegal nga territori i asaj Pale Kontraktuese;

c) mjetet lundruese të veçanta, anije, aeroplanë ose mjete të tjera transporti për të cilat besohet me arsye se janë përdorur për kontrabandën e veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore nga territori i Palës Kontraktuese Kërkuese;

dhe do të komunikojnë një raport lidhur me të Administratës Doganore të Palës Kontraktuese Kërkuese.

Kërkime, sipas kërkesës, për interes të një Pale tjetër Kontraktuese.

5. Sipas kërkesës së Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e një Pale tjetër Kontraktuese, kushtëzuar nga mundësitë dhe varur nga ligjet kombëtare në fuqi në territorin e vet, do të bëjë kërkime për të marrë fakte lidhur me kontrabandën e veprave të artit, antikave dhe pasurive të tjera kulturore nën hetim në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese, dhe do të marrë deklarata nga çdo person i lidhur me këtë kontrabandë ose nga dëshmitarë dhe ekspertë, dhe do t'i komunikojë rezultatet e kërkimit, si dhe ndonjë dokument tjetër dhe evidence, Administratës Doganore të Palës Kontraktuese Kërkuese.

Aksione nga zyrtarët e Doganës së një Pale Kontraktuese në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese.

6. Kur mjafton që faktet të jepen vetëm në formën e një deklarate të shkruar, sipas kërkesës së Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e një Pale tjetër

Kontraktuese, për aq sa ka mundësi, do të autorizojë zyrtarët e saj të paraqiten përpara gjykatës ose tribunaleve në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese si ekspertë ose dëshmitarë në çështjet e kontrabandës së veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore. Kërkesa për paraqitje, do të specifikojë, për çfarë çështje dhe në çfarë pozicioni do të dëgjohen këta zyrtarë. Administrata Doganore e Palës Kontraktuese që pranon kërkesën, në autorizimin e paraqitjes, do të deklarojë limitet të cilat zyrtarët e vet duhet të përmbushin në dhënien e fakteve.

7. Sipas kërkesës me shkrim të Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e një Pale tjetër Kontraktuese, kur e sheh të mundur dhe në kufijtë e kompetencave dhe aftësive të veta, do të autorizojë zyrtarët e administratës kërkuese të jenë prezent në territorin e Palës Kontraktuese të cilës i kërkohet informacion lidhur me kërkimet mbi, ose do të autorizojë zyrtarët që do të raportojnë mbi kontrabandën e veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore që shqetësojnë Palën Kontraktuese Kërkuese.

8. Kur shihet e përshtatshme nga të dyja Palët Kontraktuese dhe, kushtëzuar nga ligjet dhe rregullat në fuqi në territorin e tyre, zyrtarët e Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, sipas kërkesës së një Pale tjetër Kontraktuese, do të marrë pjesë në investigimet e kryera në territorin e asaj Pale Kontraktuese.

GRUMBULLIMI I INFORMACIONIT

9. Administrata Doganore e Palëve Kontraktuese do t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm, të Këshillit, në kushtet kur ky informacion është i një interesi ndërkombëtar, informacionin e specifikuar më poshtë.

10. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do të institucionalizojë dhe mbajë të freskët Indeksin Qendror të Informacioneve komunikuar atij nga Palët Kontraktuese dhe do të përdorë informacion prej tij për të përgatitur studime dhe përmbledhje të tendencave dhe mënyrave të reja në kontrabandën e veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore. Ai, periodikisht, do të rishikojë indeksin për të eliminuar informacionet, që sipas mendimit të tij, kanë dalë jashtë kohe ose janë bërë të padobishme.

11. Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese, sipas kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit, dhe kushtëzuar nga dispozitat e tjera të Konventës dhe këtij Aneksi, do të furnizojnë Sekretarin e Përgjithshëm me informacion të tillë shtesë që mund të jetë i nevojshëm për të përgatitur këto studime dhe përmbledhje, të referuara në paragrafin 10 të këtij Aneksi.

12. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do t'i shpërndajë zyrtarëve dhe shërbimeve të emëruara nga Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese informacion specifik të përmbajtur në Indeksin Qendror, në kufijtë që ai i gjykon këto informacione të dobishme, si dhe përmbledhjet dhe studimet e referuara në paragrafin 10 të këtij Aneksi.

13. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit, (nëse nuk kundërshtohet kjo gjë nga Palët Kontraktuese që kanë dhënë informacionin) do t'i shpërndajë këtë informacion UNESKO-s, Interpolit, lidhur me kontrabandën e veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore të përmbajtura në indeksin qendror, kur ka ndodhur një transport ilegal dhe kur ai e konsideron këtë informacion të dobishëm, së bashku me ndonjë studim ose përmbledhje të cilat ai ka përgatitur për këtë çështje sipas paragrafit 10 të këtij Aneksi.

14.Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit, (nëse nuk kundërshtohet kjo gjë nga Palët Kontraktuese që kanë dhënë informacionin) do t'ua shpërndajë këtë informacion UNESKO-s, Interpolit, lidhur me kontrabandën e veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore të përmbajtura në Indeksin Qendror, kur ka ndodhur një transport ilegal dhe kur ai e konsideron këtë informacion të dobishëm, së bashku me ndonjë studim ose përmbledhje të cilat ai ka përgatitur për këtë çështje sipas paragrafit 10 të këtij aneksi.

INDEKSI QENDROR, PJESA I: PERSONAT

15. Njoftimet nën këtë pjesë të Indeksit Qendror do të japin informacion lidhur me:

a) personat përfundimisht të dënuar për kontrabandë; dhe

b) kur është e mundur, personat e dyshuar për kontrabandë ose kapur në akte kontrabande në territorin e Palës Kontraktuese që bën njoftimin, megjithëse proceset penale mund të mos kenë përfunduar,

që duhet kuptuar se kur Palët Kontraktuese shmangen nga njoftimi i emrave dhe përshkrimeve të personave të përfshirë sepse këto njoftime ndalohen nga legjislacioni i tyre kombëtar, ata gjithsesi duhet të bëjnë njoftime që të përmbajnë sa më shumë nga të dhënat e vëna në listë më poshtë në këtë pjesë të indeksit qendror.

16. Informacioni që do të dërgohet, të përmbajë sa më shumë të jetë e mundur, të dhënat e mëposhtme:

a) Mbiemri;

b) Emri;

c) Emri i dhënë;

d) Pseudonimi;

e) Profesioni

f) Adresa (e tanishme);

g) Datëlindja dhe vendlindja;

h) Shtetësia/Kombësia;

i) Vendi i rezidencës dhe vendet e vizituara gjatë 12 muajve të fundit;

k) Tipi dhe numri i letrave të identifikimit, duke përfshirë vendin dhe datën e lëshimit

l) Përshkrimi fizik

1) Seksi;

2) Gjatësia;

3) Pesha;

4) Konstrukti;

5) Flokët;

6) Sytë;

7) Kompleksi;

8) Shenja të veçanta ose femërore.

m) Përshkrim shkurt të shkeljes, (duke përfshirë përshkrim të tipit dhe origjinës së mallrave të përfshira në shkelje, dhe nëse është kryer një transport ilegal ose pronësi ilegale) dhe kushtet që çuan në zbulimin e shkeljes.

n) Natyra dhe sasia e dënimit/gjobës së vënë;

o) Vëzhgime të tjera, duke përfshirë gjuhën e folur, dhe (nëse ka mundësi) shkelje të kaluara të regjistruara

p) Palën Kontraktuese që ka dhënë informacionin (duke përfshirë numrin e referencës)

17.Si rregull i Përgjithshëm, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do të qarkullojë informacionin lidhur me Pjesën I të Indeksit Qendror, të paktën në vendet e shtetësisë/kombësisë dhe rezidencës, si dhe në vendet që personi në fjalë ka vizituar 12 muajt e fundit.

INDEKSI QENDROR, PJESA II: METODAT

18. Njoftimet nën këtë Pjesë të Indeksit Qendror, do të japin informacion lidhur me metodat e kontrabandës së veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore, duke përfshirë metodat e fshehjes, në gjithë rastet e interesave të rëndësishëm ndërkombëtare. Palët Kontraktuese do të raportojnë çdo lloj përdorimi të metodave të njohura të kontrabandës, si dhe të metodave të pazakonta, ose të mundshme në mënyrë që tendencat e reja në këtë fushë të mund të zbulohen.

19. Informacioni që do të shpërndahet, sa më shumë të jetë e mundur të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

a) Përshkrim të metodave të kontrabandës. Nëse është e mundur, përshkrimin (marka, modeli, numri i regjistrimit, në rastet e mjeteve tokësore, tipi i mjetit lundrues, etj,) të çdo mjeti transporti të përdorur. Kur është e mundur, të dhëna nga targat e aprovuara ose certifikatat e kontenierëve ose mjeteve lëvizës, disenjot e të cilave janë aprovuar nën një Konventë Ndërkombëtare, si dhe për ndonjë dëmtim të vulave, pjesëve metalike, plumbosjeve, ose pjesëve të tjera të mauneve ose kontenierëve.

b) Përshkrim, nëse ka mundësi të vendit të fshehjes, duke përfshirë nëse ka mundësi, një fotografi ose skicë;

c) Përshkrim i mallrave në fjalë;

d) Vëzhgime të tjera, duke përfshirë rrethanat që çuan në zbulim;

e) Palën Kontraktuese që dërgon informacionin (duke përfshirë numrin e referencës).